

VENDIM
Nr. 10, datë 16.2.2018

**PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR SHOQËRINË
UJËSJELLËS MALËSI
E MADHE SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave, për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës Malësi e Madhe sh.a., si më poshtë:

Kategoria	Tarifat volumetrike	Tarifa fikse shërbimi	Tarifa flet (aforfe)
a) Për shërbimin e furnizimit me ujë (me matës)	lekë/m ³	lekë/muaj	lekë/muaj
1. Konsumator familjar	50	167	
2. Konsumator publik	120	167	
3. Konsumator privat	120	167	
b) Për shërbimin e furnizimit me ujë (pa matës)			
1. Konsumator familjar		167	666
c) Për shërbimin e furnizimit nga çezmat publike			500

2. Objektivat e treguesve kryesorë të performancës për vitin 2018 të jenë si më poshtë:

Treguesit e performancës	Viti 2018
Uji pa të ardhura	62.7%
Niveli i matjes	44%
Norma e arkëtimit	65%
Mbulim i kostove totale	83%
Orët e furnizimit me ujë	16 orë
Staf për 1000 lidhje	13.2 punonjës

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjetës Malësi e Madhe sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.
4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.3.2018 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani